



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.104/02-16334/23

Buxheti është një plan i të hyrave dhe shpenzimeve për një periudhë të caktuar kohore që hartohet dhe rivlerësohet në baza periodike. Buxhetimi komunal është procesi kryesor i cili lejon komunat të arrijnë shumë qëllime në rrjedhën e tyre të veprimit. Procesi i formulimit të një plani buxheti është një nga aktivitetet kryesore të çdo komune për vitin e ardhshëm me qëllim plotësimin e nevojave zhvillimore së bashku me nevojat e qytetarëve.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, në Komunën e Kaçanikut, ka prezentuar projekt buxhetin për vitin 2024-2026.

Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin 2024, do të jetë në vlerë prej 11,958,982.49€, ku ky buxhet është i ndarë në këto kategori ekonomike:

1. Paga dhe Mëditje, për vitin 2024, është : 6,759,179.49€
2. Mallra dhe Shërbime, për vitin 2024, është 1,421,513.00€
3. Shpenzime Komunale, për vitin 2024, është 200,000.00€
4. Subvencione dhe Transfere për vitin 2024, është 415,529.00€
5. Investime Kapitale, për vitin 2024, është 3,162,761.00€

Krahasuar me vitin 2023, do të kemi rritje të buxhetit në vlerë prej 1,284,293.49€.

Buxheti si akt më i rëndësishëm komunal shqyrtohet dhe miratohet në Kuvend Komunal në baza vjetore bazuar në parashikime afatmesme tri vjeçare. Institucionet komunale kanë kompetenca që ndikojnë në kualitetin e jetës së qytetarëve.

Buxheti që hartohet çdo vit nga të hyrat e parasë publike, përcakton se çfarë projekte dhe shërbime do t'u ofrohen qytetarëve, andaj duhet të jetë i shpërndarë mirë dhe i konsultuar me qytetarët. Me konsolidimin e qeverisjes lokale, buxhetet komunale janë rritur dukshëm dhe janë bërë të rëndësishëm për zhvillimin e lagjeve dhe fshatrave.

Njëra ndër parimet bazë për një qeverisje të mirë është zotimi se do të mbahen dëgjime publike me qëllim të mbledhjes së prioriteteve nëpër secilin vendbanim varësisht prej kërkesave që kanë banorët, për t'i harmonizuar pastaj në draftim të politikave lokale përfshirë buxhetin.

Ecuria e procesit të dëgjimeve buxhetore për projekt buxhetin e vitit 2024

Komuna e Kaçanikut ka themeluar grupin punues për realizimin e procesit të dëgjimeve buxhetore për buxhetin komunal 2024. Grupi punues i mbështetur nga projekti DEMOS ka realizuar një punëtori një ditore për hartimin e planit të dëgjimeve buxhetore.

Plani i dëgjimeve buxhetore është hartuar dhe gjithashtu është publikuar në ueb faqen dhe rrjetet sociale të Komunës. Plani ka paraparë gjithsej 8 dëgjime buxhetore me grupe të ndryshme.

Hartimi i këtij propozim buxheti ka ardhur edhe pas mbajtjes së konsultimit publik me qytetaret për Kornizës Afatmesme Buxhetore të miratuar në Kuvendin e Komunës në mbledhjen e datës: 30 qershor 2023.

Komuna e Kaçanikut, përmes Zyrës së Informimit dhe Komunikimit me Publikun, gjatë këtij procesi, ka punuar me përkushtim të shtuar për të ftuar në këto takime buxhetore grupet e ndryshme të interesit. Gjatë kësaj periudhe është përdore edhe databaza e punuar një vit me parë në bashkëpunim me DEMOS, ku janë ftuar edhe grupet e ndryshme të interesit me të cilat janë mbajtur këto dëgjime buxhetore. Në fund të secilit njoftim janë publikuar e-mailat e zyrtarëve ku qytetarët kanë pasur mundësi t'i dërgojnë kërkesat, sugjerimet e tyre.

Publikimet për këto dëgjime buxhetore janë bërë këtu:

Uebfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/kacanik/wp-content/uploads/sites/14/2023/07/16334.pdf>

Facebook:

<https://www.facebook.com/KomunaKacanik>

Platforma qeveritare:

<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Për përgatitjen e dëgjimeve buxhetore dhe përgatitjen e buxhetit, me 24.03.2023 Kryetari i Komunës së Kaçanikut Besim Ilazi, ka nënshkruar vendimin për formimin e grupit punues për përgatitjen e Projektbuxhetit të Komunës për vitin 2024-2026.

Përbërja e grupit:

1. Bahri Selimi- Drejtor per Buxhet dhe Financa
2. Fatlume Guri Selimi- Zyra per Informim
3. Pranvera Loku Zharku- Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm
4. Valdrini Dogani- Zyrtar Kryesor Financiar
5. Dardana Dauti- Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme
6. Suhad Dullovi- Drejtor për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari
7. Qamil Stagova- Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit
8. Ramadush Osmani- Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencia
9. Zahir Doda- Drejtor për Arsim
10. Sali Malsiu- Drejtor për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
11. Hafize Sallahu- Drejtoreshë për Kulturë, Rini e Sport

Të gjitha kërkesat e parashtruara në takimet fizike si dhe ato në formë elektronike, janë shqyrtuar nga Grupi Punues, ndërsa raporti i detajuar për kërkesat e pranuar apo refuzuara, është paraqitur në formë të plotë në shtojcën nr. 1 të këtij raporti.

Metodat e konsultimit	Data /	Numri i pjesëmarrësve	Numri i atyre që kanë dhënë komente, kërkesa / sugjerime	Shpjegimi se a po aprovohet kërkesa (nëse nuk aprovohet me dhënë shpjegimin pse jo)
Dëgjimi buxhetor me sektorin e bujqësisë	24 korrik 2023,	10	03 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa	Shumica e kërkesave janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektbuxhetin e vitit 2024.

Dëgjimi buxhetor me të rinjtë, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të Shoqërive Kulturore Artistike, grupe jo formale artistike nga komuna jonë dhe Klubet Sportive	25 korrik 2023,	18	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa	Shumica e kërkesave janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektbuxhetin e vitit 2024.
Dëgjimi buxhetor me sektorin e shëndetësisë në Komunën e Kaçanikut	27 korrik 2023,	11	6 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa	Shumica e kërkesave janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektbuxhetin e vitit 2024.
Dëgjim buxhetor me sektorin e turizmit, planifikimit urban dhe infrastrukturës	28 korrik 2023,	0	0	0
Dëgjim buxhetor me banorët e lokaliteteve Dubravë, Nikaj, Rekë, Sopinicë	31 korrik 2023,	19	9 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa	Shumica e kërkesave janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektbuxhetin e vitit 2024.
Dëgjim buxhetor me banorët e lokaliteteve Begracë, Kaçanik i Vjetër, etj	01 gusht 2023,	14	3 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa	Shumica e kërkesave janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektbuxhetin e vitit 2024.
Dëgjim buxhetor me Debat me gratë dhe vajzat nga Komuna e Kaçanikut	02 gusht 2023,	0	0	
Dëgjim buxhetor me qytetarë të Komunës së Kaçanikut	04 gusht 2023,	25	7 pjesëmarrës kanë parashtruar kërkesa	Shumica e kërkesave janë pranuar dhe janë inkorporuar në projektbuxhetin e vitit 2024.

Projekt buxheti i vitit 2024, pas përmbylljes së procesit të dëgjimeve buxhetore, do të finalizohet dhe deri më 1 shtator 2023 do të procedohet për në Kuvendin e Komunës së Kaçanikut.

Shtojca – Tabela e detajuar me informatat për kërkesat e dhëna, arsyetimet për kërkesat e pranuar dhe të refuzuara.

NR.	Temat e dëgjimit buxhetor	Kërkesat / Sugjerimet / Komentet	Kush ka dhënë kërkesë / sygjerim për projekt buxhetin e vitit 2023	Statusi i kërkesës / sugjerimi (i pranuar, pjesërisht e pranuar apo nuk është pranuar)	Arsyetimi (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
1).	Projektbuxheti i vitit 2024	ndryshim të formës së subvencioneve.	Rrustem Zenuni-asambleist	E pranuar	Përgjigja: Grupi punues pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës, mbi bazën e mundësive buxhetore dhe shpërndarjes së buxhetit në mënyrë sa më racionale, ka marrë për bazë dhe ka inkorporuar pjesërisht kërkesën e tillë në projeksionet buxhetore të vitit 2024. Buxheti për subvencione është rritur.
2).	Projektbuxheti i vitit 2024	- Rruga për Lybeten do të na ndihmonte dhe do të na lehtësonte punën neve si fermer. Andaj kërkoj që kjo rrugë sa më parë të rregullohet në bazë të mundësive të	Hamdi Deda-fermer	I pranuar pjesërisht	Për shkak të buxhetit të vogël që ka në dispozicion Komuna e Kaçanikut dhe kostos së lartë që ka realizimi i këtij projekti, ky projekt nuk mund të realizohet nga buxheti i paraparë për vitin 2024. Ne kemi propozuar që këtë projekt ta parashohim

		komunës që ka.			vetëm si kod në rast të mbështetjes nga Qeveria(Ministrat Linje) apo donator të ndryshëm . Komuna e Kaçanikut është e gatshme për bashkëfinancim të këtij projekti me rëndësi të veçantë për zhvillim të turizmit dhe lehtësimin e punëve te fermerëve .
3)	Projektbuxheti i vitit 2024	- kërkesë për rritje të subvencioneve me serra si dhe ndryshim të kriterëve për përfitimin e mekanizmave bujqësorë..	Kenan Berisha	E pranuar	Investimet në subvencione Drejtoria e Bujqësisë do ti realizoj duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve në këtë rast të fermerëve. Edhe kriteret do të vendosen në koordinim me kushtet
4)	Projektbuxheti i vitit 2024	Përkrahje me subvencione edhe për individ	Faton Zharku	E pranuar pjesërisht	2. Sipas RREGULLORE MF - NR - 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE, do te shikohen mundësitë edhe për përkrahjen e individëve , ngase në mungesë buxheti deri tani janë përkrahur vetëm OJQ-të.
5)	Projektbuxheti i vitit 2024	Më shumë projekte për rininë dhe për renovimin e Shtëpisë së Kulturës, si dhe	Shpat Bulica-Kryetar i KVRL-së	E pranuar	3. Gjithsesi se në të ardhmen do të parashikohen projekte edhe më shumë në fushën e rinisë , ndërsa

		rritje të subvencioneve dhe ndryshim apo lehtësim në kritere.			renovimi i Shtëpisë së Kulturës ka filluar me ndërtimin e hapësirave për Muzeun e Qytetit, ndërkaq sa i përket ndryshimit apo lehtësimit në kritere ato janë të përcaktuara nga RREGULLORE MF - NR - 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE dhe nuk mund të ndryshohen . 4. Në bashkëpunim me Drejtorinë përkatëse do të shikohet mundësia e caktimit të lokacionit për ndërtimin e fushës së sportit.
6)	Projektbuxheti i vitit 2024	Mirëmbajtje të objekteve, të shtohen shërbimet si në gjinekologji dhe radiologji, si dhe ta kompletojnë QKMF-në me të gjitha shërbimet e nevojshme mjekësore.	Sinan Zeneli-drejtor në QKMF	E pranuar	E pranuar
7)	Projektbuxheti i vitit 2024	Të furnizohemi me një aparat për troponinë për urgjencë, një veturë për rastet paliative, të rregullohet apo të forcohet sistemi i internetit brenda objektit të QKMF-së.	Lulzim Hoxha-Specialist i Urgjencës-	Pjesërisht	Me udhëzim administrativ 04/2020 nuk parashihet kryerja e kësaj analize. Vetura e pranuar

8)	Projektbuxheti i vitit 2024	Të rregullohet garazhda, me vetura jemi keq, sektori i vaksinimit dhe pothuajse të gjithë sektorët, edhe drejtorja nuk ka veturë zyrtare.	Nexhat Zharku-Shefi i autoparkut-	E pranuar	E pranuar
	Projektbuxheti i vitit 2024	Kërkoj që të bëhet plotësimi i autoparkut, një mirëmbajtëse të objektit, si dhe dy pika të reja për laborator.	Filkizare Demakryeinfermiere-	E pranuar	E pranuar
	Projektbuxheti i vitit 2024	Kur do të hapet ambulanta e re në Doganaj?	Ekrem Dullovi zv drejtor	E pranuar	E pranuar- Punimet ne objektin e ambulantës së re në Doganaj janë në fazën përfundimtare
9)	Projektbuxheti i vitit 2024	Kërkoj qe tek varrezat e dëshmorëve të vendoset një mbishkrim për tu bërë identifikimi i varrezave të dëshmorëve.	Tefik Vishi-drejtor i Shkollës Fillore “ Kadri Zeka”	E pranuar	Kjo do të realizohet përmes projektit për sinjalizimin e rrugëve.
10)	Projektbuxheti i vitit 2024	Menduh Krasniqi-proponoj ndërtimin e fabrikës për pastrimin e ujit në Sepetin. Në bregun mbi Sepetin, të vendosen tri shkronjat UÇK. Në këtë pjesë të rregullohet një ambient për pushues pasi që	Menduh Krasniqi-banor i fshatit Dubravë	E pranuar pjesërisht	Projekti “Ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujit te pijshëm ne Sepetin” është i koduar ne projekt buxhetin e vitit 2024 Kërkesa për rregullimin e hapësirës publike dhe vendosjen e tri shkronjave UÇK ne Sepetin do te shqyrtohet te realizohet ne kuadër te

		është një sipërfaqe shumë e përshtatshme. Rregullimi i një rruge në lagjen Imishti deri tek shkolla në Vatë.			projektit “Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike që është i koduar në projekt buxhetin e vitit 2024. *Rregullimi i trasesë se rrugicës nga lagja Imishti deri te shkolla në lagjen Vate e Epërme hynë në kuadër të planifikimeve si pjese e projektit “Ndërtimi dhe rregullimi i rrugëve rurale”
11)	Projektbuxheti i vitit 2024	Rregullimin e trotuarit nga Lumi Lepenc deri tek varrezat e dëshmorëve, krahas edhe ndriçimin publik dhe trotuari . Trotuari dhe ndriçimi publik nga varrezat e lagjes Imisht deri në drejtim të Sepetinit.	Fadil Vishi-Kryetar i Këshillit të fshatit Dubravë	E pranuar	Në planifikimet e radhës për rregullim të trotuarit në rrugën “Beteja e 25 Majit” DSHPE-ja do të shqyrton mundësinë për vazhdim të trotuarit edhe në distancën e mbetur dhe gjithashtu edhe shtrirjen e ndriçimit publik, segmentin nga Varrezat e dëshmorëve deri në lagjen Provoli dhe segmentin nga Lagja Imishti deri në Sepetin.
12)	Projektbuxheti i vitit 2024	Shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në Vatë të Epërme.	Festim Neziraj-Banor i Lagjes Neziraj	E pranuar	Shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në Vatë të Epërme do të jete prioriteti i radhës në planifikimet e drejtorisë 2024-2026
13)	Projektbuxheti i vitit 2024	ndërrimin e një gypi të ujësjellësit, pasi që ka rrjedhje të shumta si dhe shtrirjen me	Xhemil Hajdari- Banor i lagjes Hajdar	E pranuar	Sanimet në rrjetin ekzistues të ujësjellësit do të bëhen nga KRU”Bifurkacioni” nga tashme kjo

		asfalt e disa rrugicave.			kompani ka ne menaxhim rrjetin e ujësjellësit ne lagjen Hajdari-Dubrave kurse shtrimi i rrugicave me shtrese asfalti realizohet përmes kontratës “ndërtimi dhe rregullimi i rrugëve rurale”
14)	Projektbuxheti i vitit 2024	Të bëhet ndriçimi publik nga shkolla deri tek lagja Kamish, pasi që kjo rrugë është duke u shfrytëzuar nga shumë qytetar si shëtitore si dhe rregullimi i rrugës nga lagja Kamish deri tek lagja Qorri e emërtuar Fetije Qorri.	Edon Baftiu-Banor fshatit Dubravë-Asambleist	E pranuar	Pas finalizimit të shtrirjes së rrjetit të ndriçimit publik në rrugët primare të fshatrave do të shqyrtohet mundësia buxhetore dhe arsyeshmëria për shtrirjen e rrjeteve edhe në rrugët sekondare kurse shtrimi i rrugicave me shtrese asfalti realizohet përmes kontratës “ndërtimi dhe rregullimi i rrugëve rurale”
15)	Projektbuxheti i vitit 2024	Propozoj shtruarjen e një pjese të rrugës me asfalt, të pllaka e dëshmorëve në lagjen Zhark.	Bujar Baftiu-Banor i fshatit Dubravë	E pranuar	Shtrimi i pjesës së rrugicës “Avdulla Baftiu”-lagja Zharku-Biqec me shtrese asfalti realizohet përmes kontratës “ndërtimi dhe rregullimi i rrugëve rurale”
16)	Projektbuxheti i vitit 2024	Propozoj një park në mes të fshatit Rekë dhe Dubravë, konkretisht tek lagja Hajdari.	Florina Vishi-Asambleiste-banore e fshatit Dubravë	E pranuar	ndërtimi i një parku në lokacionin e propozuar do të shqyrtohet të realizohet në kuadër të projektit “Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike” që është i koduar në projekt buxhetin e vitit

					2024.
17)	Projektbuxheti i vitit 2024	Pse janë ndërprerë punimet në rezervuarin në Ivajë, ka mbetur një projekt gjysmak. Pse ka mbetur pa u shtrur e gjithë rruga me zhavorr të zmadh, poashtu kërkoj ndriçim publik të rrugës. Kanalizimi është finalizuar me letra, por punët në terren kanë mbetur të pa miratuara.	Hajredin Luta-banor i fshatit Ivajë	E pranuar	Projekti “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Ivajë”-faza II-te është i kontraktuar këtë vit dhe punimet do të fillojnë në shtrirjen e rrjetit primar dhe sekondar *Pjesa e mbetur e rrjetit të kanalizimit fekal në fshatin Ivajë do të realizohet përmes kontratës “ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike”-kontrate aktive në vitin 2023.
18)	Projektbuxheti i vitit 2024	Kanë mbetur të pa shtruar dy rrugica në Shtrazë.	Nexhmedin Lika	E pranuar	Shtrimi i rrugicave me shtrese asfalti në fshatin Strazhe realizohet përmes kontratës “ndërtimi dhe rregullimi i rrugëve rurale”
19)	Projektbuxheti i vitit 2024	Vitin e kaluar kam insistuar për ndërtimin e trotuarit tek Fusha e Pajtimit deri tek restorant Natyra, ky është një prioritet i banorëve të kësaj ane. Vazhdim i trotuarit rruga “Hetem Hasaj”. Rruga Lokale Gërllicë-gabrricë të rregullohet, poashtu të rregullohet	Rrustem Zenuni-asmableist-	E pranuar pjesërisht	Projekti “Ndërtimi i trotuarit përgjatë rrugës rajonale nga restorant Natyra deri në Fushe të Pajtimit” është i koduar në projekt buxhetin e vitit 2024. * Vazhdim i trotuarit rruga “ Hetem Hasaj” segmenti Gabrrice-Bajnice do të shqyrtohet në vlerësimet e radhës për projekt buxhetin për vitet 2025-2026.

		terreni sportiv Duraj afër xhamisë.			
20)	Projektbuxheti i vitit 2024	<p>Ndërtimi i fabrikës për ujë në Sepetin, të jetë prioritet pasi që po ka probleme me ujë të pijes. Shtrirja e ujësjellësit në Lagjen Vatë, rregullimi i parkut dhe shtratit të rekës së fshatit. Kërkoj të rregullohet trotuari dhe ndriçimi prej lumit Lepenc deri tek Varrezat e fshatit si dhe nga shkolla deri tek Lagja Kamish. Rregullimi i trasesë lagja Imisht- Dullovi, rruga “ Fetije Qorri”. Poashtu kërkoj që të ndahet një parcelë për varrezat në Dubravë.</p>	Fadil Vishi-Kryetar i Këshillit të fshatit Dubravë-	E pranuar pjesërisht	<p>Projekti “ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujit te pijshëm ne Sepetin” është i koduar ne projekt buxhetin e vitit 2024.</p> <p>* Shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në Vatë të Epërme do te jete prioriteti i radhës ne planifikimet e drejtorisë 2024-2026. ndërtimi i një parku do te shqyrtohet te realizohet ne kuadër te projektit “Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike” qe është i koduar ne projekt buxhetin e vitit 2024.</p> <p>*Rregullim i shtratit te përroskës se Rekes se Dubrave nga fshati Reke deri te lagja Kamishi-Dubrave realizohet permes kontratës “Ndërtimi i shtretërve te perrockave” projekt i koduar ne DUKMM. Ne planifikimet e radhës për rregullim te trotuarit ne rrugën “Beteja e 25 Majit” DSHPE-ja do te shqyrton mundësinë për vazhdim te trotuarit edhe ne distancën e mbetur</p>

					dhe gjithashtu edhe shtrirjen e ndriçimit publik, segmentin nga Varrezat e dëshmorëve deri ne lagjen Provoli. Shtrimi i rrugicave me shtrese asfalti ne realizohet përmes kontratës “ndërtimi dhe rregullimi i rrugëve rurale”
21)	Projektbuxheti i vitit 2024	Të rregullohet rezervuari i ujit të pijes, sepse kur ka shumë ujë, ai del jashtë dhe nuk shfrytëzohet, poashtu kërkoj të mbyllet një pusetë e hapur nga Bifurkacioni, sepse është rrezik për kalimtarë.	Fatmir Qakabanor i fshatit Bob	E pranuar	Kjo kërkesë do ti përcillet KRU”Bifurkacioni”- Njësia e Kaçanikut ngase kjo kompani ka ne menaxhim rrjetin e ujësjellësit ne qytet. Kurse dëmtimet ne rruge nga ndërhyrjet ne rrjetin e ujësjellësit do te sanohen përmes kontratës “Mirëmbajtja e rrugëve lokale”
22)	Projektbuxheti i vitit 2024	Të caktohet një lokacion për rregullimin e fushës së sportit, ndërsa më pas mundemi edhe vet si qytetarë ta rregullojmë. Të rregullohet rruga Bob-Doganaj, dimrit të mirëmbahet, poashtu kërkoj që të kontrollohen projektet në terren, sidomos projektet e bujqësisë, si dhe dua të	Ibrahim Dalloshi-Kryetar i këshillit të fshatit Doganaj-	E pranuar	Mirëmbajtja e rrugëve lokale gjate sezonës dimërore dhe verore kryhet përmes kontratës “Mirëmbajtja e rrugëve lokale”

		informohen se kur planifikohet të hapet ambulanta e re në Doganaj?			
23)	Projektbuxheti i vitit 2024	Të rregullohet një shkarpë në rrugën “Avdurrahim Shehu” rruga “Kjani Bela” të rregullohet.	Kadri Dardhishta-kryetari i këshillit të zonës urbane 1	E pranuar	Do të shikohen mundësitë përmes projekteve që janë në kuadër të ndërtimit të rrugëve urbane.
	Projektbuxheti i vitit 2024	Të rregullohet qatia e shkollës, sepse objekti i ri po pik gjatë të reshurave, kanali i ujitjes ka mbetur në gjysmë, një pjesë e kanalizimit po kemi probleme, faji është i yni por kërkojmë ndihmën e komunës për intervenim	Azem Koraqi-Kryetari i Këshillit të Fshatit Kovaqec	E pranuar	Përmes kontratës “ndërtimi i rrjeteve te kanalizimit fekal dhe atmosferik” intervenohet edhe ne segmentet e shkurtra te evidentuara nga kryetaret e këshillave te fshatrave.
24)	Projektbuxheti i vitit 2024	Kërkesë për rregullimin e ujësjellësit, kanalizimit dhe trotuarit në disa pjesë në Kaçanik të Vjetër	Banorët e fshatit Kaçanik i Vjetër	E pranuar	Këtë vit ne kuadër te projekti “Ndërtimi i rrjeteve te ujësjellësit “do te shtohet sasia e ujit përmes hapjes se një pusi shtese për K. Vjetër. Përmes kontratës “ndërtimi i rrjeteve te kanalizimit fekal dhe atmosferik” kemi filluar ne ndërtim te rrjeteve te reja ne K.Vjeter (rr. “Çlirimtaret”). * Kurse dëmtimet ne trotuare nga ndërhyrjet e ndryshme te

					individëve do të sanohen përmes kontratës "Mirëmbajtja e rrugëve lokale
25)	Projektbuxheti i vitit 2024	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës, segmenti Runjevë-Stagovë për vitin 2024;	Faton Zharku	E pranuar	Ky projekt është i koduar ne Kornizën Afatmesme Buxhetore për Komunën e Kaçanikut 2024-2026
26)	Projektbuxheti i vitit 2024	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës, segmenti Kaçaniku i Vjetër për vitin 2026:	Faton Zharku	E pranuar	Ky projekt është i koduar ne Kornizën Afatmesme Buxhetore për Komunën e Kaçanikut 2024-2026
27)	Projektbuxheti i vitit 2024	Vendosja e projektorëve me drita në drejtim të Gurit të shpuar;	Faton Zharku	E pranuar	Ne rrugën "Idriz Seferi"-segmenti ka Teqja është i planifikuar dhe kontraktuar rregullimi i ndriçimit publik përgjatë tere segmentit rrugor
28)	Projektbuxheti i vitit 2024	Vendosja e orës së qyettit te Kalaja e Kaçanikut;	Faton Zharku	E pranuar	Ne tabelën digjitale te vendosur te Kalaja është planifikuar te figuroj edhe ora digjitale ne tabele
29)	Projektbuxheti i vitit 2024	Krijimi i parkingjeve të reja për banorët në rrugën 'Skenderbeu' përgjatë hekurudhës;	Faton Zharku	E pranuar pjesërisht	Kjo hapësire publike është ne pronësi te Hekurudhave te Kosovës dhe pas përfundimit te punimeve ne rehabilitimin e hekurudhës do te shqyrtohet mundësia dhe hapësira e mundshme për krijim te vendparkingjeve

30)	Projektbuxheti i vitit 2024	Mbjellja e fidaneve (lloji i blirit, pauloënisë, jargovanit, etj) përgjatë korzës nga Ura e Hazirit deri te Xhamia e Dëshmorëve;	Faton Zharku	E pranuar	Ky propozim do te trajtohet ne kuadër te projektit "ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike "që është i koduar ne Kornizën Afatmesme Buxhetore për Komunën e Kaçanikut 2024-2026
31)	Projektbuxheti i vitit 2024	Lejimi i numrit kateve të objekteve ndërtimore B+S+P+10 në tri zonat e qytetit;	Faton Zharku		Me Planin Zhvillimor Komunal nuk caktohet etazhoteti i objekteve. Me këtë plan caktohet vetëm destinomi i një sipërfaqe të tokës. Etazhitetin, përkatësisht numrin e kateve e caktojnë hartat zonale. Dokumenti Hartat Zonale do të punohet pas aprovimit te PZK-se.
32)	Projektbuxheti i vitit 2024	Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc nga Bobi deri në Kovaçec (si fillim); -2026	Faton Zharku	E pranuar	Ky propozim do te trajtohet ne kuadër te projektit "ndërtimi dhe rregullimi i shtretërve te përroskave dhe lumenjve" qe është i koduar ne Kornizën Afatmesme Buxhetore për Komunën e Kaçanikut 2024
33)	Projektbuxheti i vitit 2024	Rregullimi i shtratit të lumit Nerodime nga Xhamia e Dëshmorëve deri në Runjevë (si fillim);	Faton Zharku	E pranuar pjesërisht	Ky propozim do te trajtohet ne kuadër te projektit "ndërtimi dhe rregullimi i shtretërve te përroskave dhe lumenjve" që është i koduar ne Kornizën Afatmesme Buxhetore për Komunën e Kaçanikut 2024-2026
34)	Projektbuxheti i vitit 2024	Rregullimi i shtratit të lumit nga vendi i bashkimit të dy	Faton Zharku	E pranuar pjesërisht	Ky propozim do te trajtohet ne kuadër te projektit "ndërtimi dhe rregullimi i shtretërve

		lumenjëve deri te ura e trenit në jug të qytetit;			te përroskave dhe lumenjve” qe është i koduar ne Kornizën Afatmesme Buxhetore për Komunën e Kaçanikut 2024-2026
35)	Projektbuxheti i vitit 2024	Ndërtimi i një rezevuari të ujit të pijshëm në pjesën lindore të qytetit;	Faton Zharku	E pranuar	Ky propozim do te trajtohet ne kuadër te projektit ”ndërtimi dhe rregullimi i rrjeteve te ujësjellësit “që është i koduar ne Kornizën Afatmesme Buxhetore për Komunën e Kaçanikut 2024-2026
36)	Projektbuxheti i vitit 2024	Hapja e një rruge të re për automjete dhe për nxënësit e Shkollës Filllore 'Emin Duraku' në Dushkajë. Në drejtim të shkollës të hapet rruga dhe me pas dalje te ura e trenit afër Xhamisë së Dëshmorëve;		E pranuar pjesërisht	Ju njoftojmë se janë duke u kryer punët për rehabilitimin e rrugëve urbane, ku një pjese e këtij projekti është Zgjerimi i Rrugës “Emsale Frangu”, prej vendkalimit hekurudhor deri te Shkolla e Mesme e Ultë “ Emin Duraku”. Poashtu është duke u punuar edhe vendkalimi nen hekurudhe afër ETC-se. Pranë këtij vendkalimi do te ndërtohet edhe një urë mbi Lumin Nerodime, neper te cilën do te kalojnë automjetet dhe këmbësoret. Këto pune janë të parapara te kryhen gjate këtij viti. Projekti ndërtimi dhe rehabilitimi i rrugëve urbane do te vazhdoje edhe ne vitin 2024.
37)	Projektbuxheti i vitit 2024	Në bashkëpunim me KEDS-in të bëhet dhe të	Faton Zharku	E pranuar	Ne rrugën “Qamil Ilazi” dhe “Sali Bajra” me

		hartohet një për vendosjen e telave të rrymës në tokë në pjesët e qytetit;			kohe nga komuna gjate rehabilitimit te rrugëve është ndërtuar edhe infrastruktura nëntokësore për shtrirjen e rrjetit te energjisë elektrike. Janë shtrire gypat dhe janë punuar pusetat sipas standardeve te kërkuara nga KEDS-i.
38)	Projektbuxheti i vitit 2024	Ndërtimi i parkingut të ri nën oborrin e Shkollës së Mesme 'Skenderbeu' (për tre vite);	Faton Zharku	E refuzuar	- Nuk është planifikuar asnjëherë parking nën oborrin e Gjimnazit "Skenderbeu".
39)	Projektbuxheti i vitit 2024	Shtimi i ndriçimit në qytet dhe lagjet tjera;	Faton Zharku	E pranuar pjesërisht	Ky propozim do te trajtohet ne kuadër te projektit "Rregullimi ndriçimit publik" qe është i koduar ne Kornizën Afatmesme Buxhetore për Komunën e Kaçanikut 2024-2026
40)	Projektbuxheti i vitit 2024	Ndërtimi i fushës së tenisit prapa palestrës së sportive;	Faton Zharku	E pranuar	Fusha e tenisit është duke u ndërtuar mbrapa objektit të palestrës sportive, punimet janë në përfundim e sipër.
41)	Projektbuxheti i vitit 2024	. Ndërtimi i shkollës së Mesme të Mjekësisë afër QKMF-së;	Faton Zharku	nuk është pranuar	- Nuk kemi nevojë për objekte shkollore për

					shkolla të mesme të larta sepse dy shkollat e mesme të larta kanë hapësirë të mjaftueshme për çfarëdo drejtimi.
42)	Projektbuxheti i vitit 2024	Vendosja e emrit me shkronja KAÇ♥NIK te parku i qytetit.	Faton Zharku	E pranuar	Ky propozim do te trajtohet ne kuadër te projektit "ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike "që është i koduar ne Kornizën Afatmesme Buxhetore për Komunën e Kaçanikut [2024-2026

Përgatiti: grupi punues për hartimin e buxhetit

Kaçanik - 20.08.2023

Bahri Selimi

Drejtore për Buxhet dhe Financa



kryesues i grupit

